

DEKRET
Nr.1706, datë 22.1.1997

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8030, DATË 15.11.1995 "PËR KONTRIBUTIN E
SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA"**

Në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

DEKRETOJ:

Neni 1

Pas nenit 2 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje:

"Qytetarët e pastrehë që kanë aktmarrëveshje për strehim me organet e pushtetit lokal, për efekt të planeve rregulluese sipas dispozitave ligjore për këtë qëllim, në rast se kërkojnë të zgjidhin problemin e strehimit nëpërmjet tregut të lirë të banesave, do të përfitojnë një shumë falas të barabartë me koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe sipas strukturës së apartamentit në aktmarrëveshjet e mësipërme.

Kjo shumë do të shumëzohet me koeficientin "k" të nenit 3 të këtij ligji.

Qytetarët e pastrehë me aktmarrëveshje do të trajtohen me përparësi absolute nga Banka e Kursimeve, në bazë të listave të dërguara nga organet e pushtetit lokal sipas dispozitave në fuqi.

Qytetarët e pastrehë me aktmarrëveshje që kërkojnë të zgjidhin problemin e strehimit të tyre nëpërmjet banesave të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, do të vazhdojnë të trajtohen sipas dispozitave në fuqi për këtë qëllim."

Neni 2

Dispozitat ligjore që bien në kundërshtim me këtë dekret, shfuqizohen.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKES
Sali Berisha